





RAPORTI I PERFORMANCËS

2024

BASHKIA
ELBASAN



Dokumenti bazohet në të dhënat e Sistemit të Matjes së Performances 2025 për vitin 2024. Ky raport është prodhuar nga Bashkia ELBASAN me asistencën e “Bashki të Forta”, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport vlerësimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet dhe qëndrimet e SDC-së, Qeverisë së Suedisë dhe Helvetas.



Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



<u>Fjalor Shpjegues</u>	5
<u>Qellimi I Raportit</u>	9
<u>Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë</u>	9
<u>Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë</u>	10
<u>SHERBIME PUBLIKE VENDORE</u>	11
 <u>Arsimi Paraniversitar</u>	11
 <u>Menaxhimi i Mbetjeve</u>	18
 <u>Mbrojtja nga zjarri</u>	22
 <u>Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit</u>	24
 <u>Administrimi i pyjeve dhe kullotave</u>	27
 <u>Mbrojtja Sociale</u>	31
<u>QEVERISJA E MIRE</u>	31
 <u>Burimet Njerëzore</u>	38
 <u>Transparenca</u>	43
 <u>Barazia Gjinore</u>	46
<u>EU Integrimi në BE</u>	48
<u>MENAXHIMI FINANCIAR</u>	51
<u>Përfundime dhe Rekomandime</u>	55

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-

treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njërive të vetëqeverisjes vendore.

Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Këto përfshijnë, ndër të tjera, , ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe cerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujitjen dhe kullimin etj. Sipas perkufizimit the ligjit “janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative’

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mbliidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transferrat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transferrat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve ne cdo fushe paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. “Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara”).
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2023 / 2024	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2024} - \text{Vlera 2023}) / \text{Vlera 2023} \times 100$.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. (Vlera 2024 – Vlera 2023). Simboli i Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës:  = vlere absolute ndryshimi pozitiv  =vlere absolute ndryshimi negative.  = nuk ka ndryshim (vlera mbetet e njëjtë)  = mungojnë të dhënat (nuk raportohen vlera për një ose të dy vitet).

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm “vlera positive ndryshimi = jeshile”. Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv.

Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përmbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

QELLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2025 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Elbasan, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025) me të dhënat e vitit 2023, 2024.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë ELBASAN

Bashkia Elbasan është një nga njësitë më të mëdha urbane në vend dhe qendra e qarkut me të njëjtin emër. Me një sipërfaqe prej rreth 872 km² dhe një popullsi prej rreth 117,726 banorësh (sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2024), ajo përbëhet nga 6 lagje dhe 12 njësi administrative dhe përfshin një kombinim të zonave urbane, rurale dhe malore, duke krijuar një territor me diversitet të gjerë ekonomik, mjedisor dhe kulturor.

Qyteti i Elbasanit është një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike dhe historike të Shqipërisë së Mesme, me tradita të forta në industri, arsim, kulturë dhe tregti. Territori bashkiak përfshin një rrjet të dendur të fshatrave dhe zonave bujqësore që kontribuojnë në ekonominë lokale përmes prodhimit bujqësor dhe blegtoral, ndërkohë që zona urbane shërben si pol zhvillimi për bizneset dhe institucionet publike.

Zhvillimi ekonomik i bashkisë mbështetet në sektorë të ndryshëm: bujqësinë, shërbimet, industrinë dhe turizmin kulturor, duke e bërë Elbasanin një territor me potencial të lartë për investime të qëndrueshme. Pozicioni strategjik përgjatë aksit kombëtar Tiranë–Kapshticë, infrastruktura arsimore e zhvilluar dhe tradita e bashkëjetesës qytetare janë elemente që e forcojnë rolin e saj si qendër rajonale.

Megjithatë, bashkia përballë edhe me sfida strukturore, si migracioni i brendshëm dhe i jashtëm, rritja e pabarazisë midis zonës urbane dhe asaj rurale, si dhe nevoja për rritjen e kapaciteteve administrative dhe dixhitalizimin e shërbimeve publike. Përballë këtyre sfidave, Bashkia Elbasan ka ndërmarrë një proces të gjerë reformash për modernizimin e administratës, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët e saj.

Sfidat dhe Prioritetet Strategjike të Bashkisë Elbasan

Bashkia Elbasan përballlet me një sërë sfidash strukturore dhe zhvillimore që ndikojnë në performancën e përgjithshme dhe në cilësinë e jetës së qytetarëve. Si një bashki e madhe dhe me karakter të kombinuar urban–rural, Elbasani përbën një territor kompleks, ku përballen dinamika të forta ekonomike me problematika sociale dhe mjedisore.

Sfidat kryesore përfshijnë:

- **Migracioni i brendshëm dhe i jashtëm**, që po çon në ulje të popullsisë aktive dhe plakje të strukturës demografike;
- **Pabarazitë territoriale** midis zonës urbane dhe njësive rurale, sidomos në qasje ndaj shërbimeve publike;
- **Niveli ende i kufizuar i të ardhurave vendore** në raport me potencialin fiskal të territorit;
- **Nevoja për menaxhim më të mirë të mbetjeve dhe infrastrukturës mjedisore**, për shkak të zgjerimit urban dhe presionit turistik;
- **Kufizime në kapacitetet njerëzore dhe teknike** për planifikim strategjik dhe matje të performancës;
- **Rritja e kërkesës për shërbime sociale dhe arsimore cilësore**, veçanërisht në zonat periferike;
- **Nevoja për modernizimin e administratës dhe digjitalizimin e shërbimeve publike** për qytetarët.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, Bashkia Elbasan ka përcaktuar **prioritetet e saj strategjike për periudhën 2024–2026**, të cilat përfaqësojnë drejtimet kryesore të politikave lokale dhe investimeve:

1. **Rritja e qëndrueshmërisë financiare dhe menaxhimi efikas i burimeve publike**, përmes zgjerimit të bazës tatimore vendore dhe optimizimit të kostove të shërbimeve;
2. **Zhvillimi i infrastrukturës publike** në nivel urban dhe rural, me fokus te transporti, mbetjet, ujitja dhe menaxhimi i burimeve natyrore;
3. **Fuqizimi i kapitalit njerëzor dhe shërbimeve sociale**, me theks në arsim, mbrojtje sociale dhe barazi gjinore;

4. **Promovimi i zhvillimit ekonomik vendor** përmes mbështetjes së sipërmarrjeve lokale dhe zhvillimit të turizmit kulturor e mjedisor;
5. **Përmirësimi i qeverisjes vendore**, përmes forcimit të njësisë së performancës, përdorimit të të dhënave në vendimmarrje dhe rritjes së transparencës ndaj qytetarëve;
6. **Integrimi i standardeve të Bashkimit Evropian** në politikat lokale, veçanërisht në menaxhimin mjedisor, qeverisjen e mirë dhe barazinë gjinore.

Këto prioritet janë pjesë e strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bashkisë Elbasan dhe do të shërbejnë si boshti kryesor për planifikimin, buxhetimin dhe matjen e performancës në vitet në vijim.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2024
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë	117726.00
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km2)	872.03
Sipërfaqe publike e bashkisë në km2	22.2
Sipërfaqja e njësive administrative në total	849,83
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor(në ha)	54979.01
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	16587.00
Numri total i njësive administrative të bashkisë	12
Numri i fshatrave	116
Punonjës të bashkisë në total	1388
Numri total i punonjësve femra të bashkisë	836
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	552
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	435

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësiave të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performances bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimi parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjere vendor që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.

ARSIMI PARANIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.”

Funksioni 23.12: “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.”

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore (23.11), si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit 23.12, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.

ANALIZA E SHERBIMIT

Arsimi parauniversitar në Bashkinë Elbasan është ndër sistemet më të zhvilluara në nivel vendor, me mbulim të plotë të territorit dhe bashkëekzistencë funksionale midis institucioneve publike dhe private. Në territorin e bashkisë operojnë 4 çerdhe publike dhe 1 private, si dhe 117 kopshte (106 publike dhe 11 private), që sigurojnë akses të gjerë për fëmijët në moshën 0–6 vjeç. Funksionet që mbulon bashkia janë të përcaktuara nga nenet 23.11 dhe 23.12 të Ligjit nr. 139/2015 dhe përfshijnë mirëmbajtjen e infrastrukturës, administrimin e personelit ndihmës dhe bashkërendimin me institucionet arsimore.

Analiza e performancës

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ruajti mbulim 100 % të fëmijëve në arsimin parashkollor, duke treguar stabilitet të rrjetit dhe funksionim të qëndrueshëm të shërbimit. Megjithatë, shkalla e regjistrimit në çerdhe publike pësoi rënie të lehtë (nga 96.7 % → 95.9 %), një prirje që lidhet me uljen e popullsisë në moshë të hershme dhe migrimin e familjeve të reja drejt qendrave të tjera urbane. Infrastruktura mbetet solide: numri i godinave arsimore u rrit me 1 njësi (+0.4 %), duke reflektuar investime të qëndrueshme në mirëmbajtje.

Raporti fëmijë-mësues

Grafiku i raportit fëmijë-mësues tregon përmirësim të dukshëm në cilësinë e kujdesit dhe ndarjen e ngarkesës arsimore.

- Në total, raporti ka rënë nga 13.26 në 12.40 (-6 %), duke sinjalizuar më pak fëmijë për çdo edukator dhe për rrjedhojë më shumë vëmendje individuale.
- Në kopshte publike, raporti ra nga 14.21 në 13.79 (-3 %), ndërsa në kopshte private u ul nga 12.30 në 11.02 (-10 %).
- Në zonat rurale, raporti publik është më i ulët (11.9 nxënës/mësues) krahasuar me urbanin (15.0 nxënës/mësues), duke treguar se klasat në fshatra janë më të vogla, por shpesh të fragmentuara gjeografikisht, gjë që rrit kostot operacionale.
- Në arsimin privat, si në qytet ashtu edhe në fshat, raportet janë dukshëm më të ulëta (11.6 urban / 7.4 rural), çka dëshmon për investime në cilësinë e mësimdhënies, por edhe për qasje më të shtrenjtë që nuk është e përballueshme për të gjitha familjet.

Këto të dhëna tregojnë se bashkia ka ruajtur standarde të mira të cilësisë, por rënia e përgjithshme e popullsisë në moshë shkollore mund të çojë në “nën-përdorim” të infrastrukturës dhe nevojë për rishpërndarje të stafit ndërmjet njësive urbane dhe rurale.

Disagregimi gjinor

Grafiku i disagregimit gjinor tregon një balancë të mirë në pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në arsimin e hershëm.

- Në çerdhe publike, pjesëmarrja e vajzave mbetet e lartë (96.8 %) dhe pothuajse e barabartë me atë të djemve (95.2 %), me ndryshime minimale ndërvite.
 - Në kopshte publike, vajzat kanë pak më shumë përfshirje (85.8 %) se djemtë (83.5 %), duke treguar një ekuilibër të qëndrueshëm.
 - Në arsimin privat, vajzat përbëjnë një përqindje më të lartë (17.2 %) krahasuar me djemtë (13.6 %), çka mund të interpretohet si rezultat i preferencës së familjeve për t'i ofruar vajzave kushte më të sigurta dhe më të personalizuar në institucione private.
- Këto të dhëna tregojnë se barazia gjinore në qasje është pothuajse e plotë, por nevojitet monitorim i vazhdueshëm për të siguruar që trendet e ardhshme demografike të mos sjellin devijime në grupmosha të caktuara apo zona rurale.


Përmbledhje

Në përmbledhje, Bashkia Elbasan ka një sistem arsimor të qëndrueshëm, me cilësi në përmirësim dhe akses të barabartë gjinor. Ndërkohë që infrastruktura është konsoliduar dhe raporti fëmijë-mësues është ulur ndjeshëm. Bashkia ka në zbatim **Planin Vendor të Shërbimeve Parashkollore 2024–2026**, ndërsa **Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar 2025–2028** është **miratuar me VKB** dhe kërkon zbatim të plotë, monitorim dhe përputhje me objektivat kombëtare.


Megjithatë, sektori përballlet me sfida të lidhura me demografinë, regjistrimet në çerdhe dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore ndërmjet zonave urbane dhe rurale.

Arritje (2024)	- Rritje e lehtë e numrit të godinave arsimore (+1).- Përmirësim i raportit fëmijë-mësues (-6 %).- Rritje e pjesëmarrjes së vajzave në arsimin privat (+19 %).- Mbulim 100 % në arsimin parashkollor. - Zbatim i Planit të Shërbimeve Parashkollore 2024–2026 në vitin e parë të tij.
Sfida	- Rënie e regjistrimit në çerdhe publike (-0.8 p.p.).- Rënie e popullsisë 0–6 vjeç dhe migrim i brendshëm..- Rishpërndarje e pabarabartë e stafit midis zonave urbane e rurale. - Nevoja për monitorim të fuqizuar të Planit Parauniversitar 2025–2028 , sapo të nisë zbatimin.
Objektiva për 2025	- Zbatim dhe monitorim i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar 2025–2028. - Zbatim i vazhdueshëm i Planit të Shërbimeve Parashkollore 2024–2026 , me fokus në cilësi dhe përfshirje.- Optimizimi i shpërndarjes së stafit arsimor.- Rritja e përfshirjes në çerdhe dhe monitorimi i balancës gjinore.- Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave dhe analizës së performancës.

Shkalla e Regjistrimit ne kopshte, sipas disagregimit gjinor dhe funksional



Shkalla e Regjistrimit ne kopshte, sipas disagregimit gjinor dhe funksional



A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	%	96.71	95.89	-0.82	↓	Përkeqësuar		-1%
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim		
Tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private	nxënës/mësues	13.26	12.40	-0.85	↓	Përkeqësuar		-6%
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	239.00	240.00	1.00	↑	Përmirësuar		0%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në çerdhe publike	%	96.88	96.82	-0.06	↓	Përkeqësuar		0%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të djemve në çerdhe publike	%	96.40	95.19	-1.20	↓	Përkeqësuar		-1%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në kopshte publike	%	85.51	85.82	0.31	↑	Përmirësuar		0%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të djemve në kopshte publike	%	84.11	83.48	-0.63	↓	Përkeqësuar		-1%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të vajzave në kopshte private	%	14.49	17.20	2.71	↑	Përmirësuar		19%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit të djemve në kopshte private	%	15.89	13.62	-2.27	↓	Përkeqësuar		-14%

Nen-tregues	Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	218.00	218.00	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Nen-tregues	Godina Arsimore private sipas nivelit arsimor	numër	21.00	23.00	2.00	↑	Përmirësuar		10%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike	%	84.78	84.63	-0.16	↓	Përkeqësuar		0%
Nen-tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte private	%	15.22	15.37	0.16	↑	Përmirësuar		1%
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	14.21	13.79	-0.42	↓	Përkeqësuar		-3%
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte private	nxënës/mësues	12.30	11.02	-1.28	↓	Përkeqësuar		-10%
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike ne zona rurale	nxënës/mësues	12.28	11.93	-0.35	↓	Përkeqësuar		-3%
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike ne zona urbane	nxënës/mësues	15.47	15.05	-0.42	↓	Përkeqësuar		-3%
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte private ne zona rurale	nxënës/mësues	8.80	7.43	-1.37	↓	Përkeqësuar		-16%
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte private ne zona urbane	nxënës/mësues	12.73	11.60	-1.13	↓	Përkeqësuar		-9%

B) Shtojcë: Të dhënat burim

Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki	395.00	365.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	382.00	350.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës nga 3-6 vjeç në bashki	3720.00	3584.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	3154.00	3033.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private	566.00	551.00	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte publike	222.00	220.00	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte private	46.00	50.00	Numër
Numri i çerdheve publike në bashki	4.00	4.00	Numër
Numri i çerdheve private në bashki	1.00	1.00	Numër
Numri i kopshteve publike në bashki	106.00	106.00	Numër
Numri i kopshteve private në bashki	10.00	11.00	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	92.00	92.00	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	5.00	5.00	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	16.00	16.00	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	5.00	5.00	Numër
Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	0.00	0.00	Po/Jo



MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënie të granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

ANALIZA E SHËRBIMIT

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ka ruajtur performancë të lartë dhe të qëndrueshme në menaxhimin e mbetjeve, duke garantuar mbulim 100% të popullsisë urbane dhe rurale me shërbimin e pastrimit.

Ky rezultat e pozicionon Bashkinë Elbasan si një nga bashkitë model në Shqipëri për mbulimin dhe funksionimin e plotë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

Njëkohësisht, është evidentuar rritje e sasisë së mbetjeve të gjeneruara për frymë dhe rritje e të ardhurave nga tarifa e shërbimit, çka tregon një zhvillim të qëndrueshëm urban dhe rritje të vetëmbulimit financiar të sektorit.

1. Mbulimi me shërbim të menaxhimit të mbetjeve

- Mbulimi i popullsisë urbane dhe rurale me shërbim pastrimi mbetet 100%, pa ndryshim nga viti 2023.
Të gjitha 6 njësitë urbane dhe 116 fshatra janë të mbuluara plotësisht me shërbim, duke garantuar qasje të barabartë dhe standarde të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve në gjithë territorin.
Ky tregues i qëndrueshëm konfirmon funksionimin efektiv të kontratave të pastrimit dhe bashkëpunimin e ngushtë midis bashkisë dhe operatorëve lokalë të shërbimit.

2. Gjenerimi dhe trajtimi i mbetjeve

- Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej është rritur nga 29,344 ton në 31,037 ton, me një rritje prej 5%, që korrespondon me një rritje nga 135.3 kg/banor në 142.7 kg/banor. Kjo rritje lidhet kryesisht me zgjerimin e konsumit urban, rritjen e popullsisë aktive, si dhe me rritjen e mbulimit efektiv të shërbimit, që ka bërë të mundur regjistrimin më të plotë të sasisë reale të mbetjeve të gjeneruara.

Në këtë kuadër, Bashkia Elbasan ka vijuar zbatimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve, i miratuar në vitet e mëparshme, duke integruar masa për reduktimin e mbetjeve në burim, rritjen e riciklimit dhe sensibilizimin qytetar për ndarjen e mbetjeve.


3. Mbulimi financiar dhe efienca ekonomike

- Të ardhurat nga tarifa e shërbimit të mbetjeve janë rritur nga 147.9 milion lekë në 183.5 milion lekë (+24%), ndërkohë që shpenzimet për ofrimin e shërbimit kanë mbetur pothuajse të pandryshuara (-0.2%).
- Si rezultat, përqindja e mbulimit të kostos nga tarifa është rritur nga 86% në 107%, që përfaqëson një rritje prej 24%, duke treguar përmirësim të qëndrueshmërisë financiare të sektorit.

Mbulimi 100% i kostove nga tarifa është një arritje shumë e rëndësishme e bashkise. Vlera prej 7% e mbledhur, që shkon përtej shpenzimeve për shërbimin do të përdoret për mirëmbajtje në të njëjtin sektor vitin e ardhshëm.

4. Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve

- Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve është në fuqi dhe në zbatim të plotë për të dytin vit radhazi (2019–2024), duke mbështetur menaxhimin e qëndrueshëm të këtij sektori në përputhje me strategjitë kombëtare për ekonominë qarkulluese. Ky plan përfshin masa për parandalimin e ndotjes, reduktimin e depozitimit në landfill, përmirësimin e grumbullimit selektiv, dhe përfshirjen e sektorit privat dhe qytetarëve në proces.
-



Tematika	Sfida kryesore	Arritjet 2024	Objektivat 2025
 Menaxhimi i Shërbimit	Rritje e sasisë së mbetjeve të gjeneruara për frymë (+5%) dhe nevojë për ndarje në burim	Mbulim 100% i popullsisë me shërbim pastrimi urban e rural dhe zbatim i plotë i planit vendor	Forcim i mekanizmave për ndarjen në burim dhe reduktim të mbetjeve të depozituara
 Qëndrueshmëria Financiare	Tarifa ende e pandiferencuar sipas volumit apo kategorisë së konsumatorit	Rritje e mbulimit të kostos nga 86% → 107%, duke tejkaluar shpenzimet për shërbimin	Konsolidim i sistemit të tarifimit dhe ruajtje e vetë-mbulimit 100%
 Zhvillimi i qëndrueshëm	Mungesë investimesh për riciklim dhe përfshirje të ulët të qytetarëve	Vijim i fushatave të sensibilizimit dhe funksionim i qëndrueshëm i kontratave të pastrimit	Rritje e nivelit të riciklimit dhe përfshirjes së sektorit privat në menaxhim
 Administrimi i Planit Vendor	Nevoja për përditësim të mekanizmave të planifikimit dhe monitorimit, për të arritur objektivat e riciklimit dhe për të vendosur sisteme funksionale të ndarjes në burim.	Zbatim i plotë i planit ekzistues për 2019–2024. Monitorim i treguesve të performancës dhe raportim i rregullt.	Zbatim dhe monitorim i Planit të ri Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve 2025–2030 . Integrim i objektivave të ekonomisë qarkulluese dhe digjitalizimi i monitorimit të grumbullimit/transportit.

A) TREGUESIT PËRMBLEDHËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	?	0%
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	253.52	263.64	10.12	↑	Përmirësuar	?	4%
Tregues	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	85.80	106.67	20.87	↑	Përmirësuar	?	24%
Tregues	Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve i miratuar ose në zbatim	Numër	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	?	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	?	0%
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	?	0%

Të dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	6.00	6.00	Numër
Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	6.00	6.00	Numër
Numri fshtreve të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	116.00	116.00	Numër
Numri fshatrave në territorin e bashkisë	116.00	116.00	Numër
Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	29344000.00	31037300.00	Kg
Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	147927.00	183502.00	mijë Lekë
Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	172406.00	172028.00	mijë Lekë
Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo)
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	115746.00	117726.00	Numër



MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret.

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan tregon qendrueshmeri në kapacitetet e mbrojtjes nga zjarri, si në aspektin e personelit, ashtu edhe në nivelin e ndërhyrjeve të kryera.

ANALIZA E SHËRBIMIT

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm të kapaciteteve të shërbimit zjarrfikës, me një rritje të lehtë të numrit të efektivëve aktivë nga 30 në 31 punonjës (+3%). Ndërkohë, flota e mjeteve zjarrfikëse ka mbetur e pandryshuar, me 6 automjete funksionale.

Kjo rritje e vogël në burimet njerëzore ka sjellë **përmirësim minimal** të raportit zjarrfikës për 1,500 banorë, i cili ka kaluar nga **0.39 në 0.39**, duke reflektuar një rritje prej **+2%** si rezultat i ndryshimit të popullsisë dhe shtimit të një efektiv.

1. Kapacitetet njerëzore dhe teknike

- Numri i efektivëve zjarrfikës është rritur nga 30 në 31, duke përmirësuar lehtë raportin e shërbimit ndaj popullsisë.
- Raporti zjarrfikës për 1,500 banorë është rritur nga **0.39 në 0.39**, me trend **pozitiv (+0.01)**.
- Numri i mjeteve zjarrfikëse ka mbetur i njëjtë (6 mjete), duke ruajtur raportin prej **0.51 mjete për 10,000 banorë**, me një ulje të lehtë (-2%) për shkak të rritjes së popullsisë.

2. Territori dhe risku operacional

Bashkia Elbasan mbetet një zonë me risk të lartë, për shkak të kombinimit të zonave urbane të dendura dhe njësive rurale me sipërfaqe pyjore, veçanërisht gjatë sezonit veror.

Rritja me vetëm një efektiv, edhe pse pozitive, nuk mjafton për të përmirësuar ndjeshëm mbikëqyrjen territoriale. Megjithatë, ruajtja e mjeteve në gjendje të mirë funksionale mbështet reagimin efektiv ndaj emergjencave.

Bashkëpunimi me Agjencinë e Mbrojtjes Civile, Policinë Bashkiake dhe njësitet administrative mbetet thelbësor për zbatimin e Planit Vendor të Mbrojtjes Civile.

A) TREGUESIT PËRMBLEDHËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.39	0.39	0.01	↑	Përmirësuar	?	2%
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.52	0.51	-0.01	↓	Përkeqësuar	?	-2%

C) SHTOJCË: TË DHËNAT BURIM (TBL_TEDHENAT)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	30.00	31.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	115746.00	117726.00	Numër
Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	6.00	6.00	Numër

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funkzioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimin të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

ANALIZA E SHERBIMIT

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ka shënuar përmirësim të qëndrueshëm në menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, duke reflektuar rritje të funksionalitetit të rrjetit ekzistues dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të kanaleve bujqësore. Sistemi i ujitjes dhe kullimit përbën një element kyç për qëndrueshmërinë e sektorit bujqësor dhe për reduktimin e rrezikut nga përmbytjet, veçanërisht në njësitë me intensitet të lartë bujqësor si Shushicë, Bradashesh dhe Shirgjan.

1. Sipërfaqja bujqësore e mbuluar me rrjet ujitje/kullimi

- Përqindja e tokës bujqësore të pajisur me kanale ujitje/kullimi është 44.7%, në nivel të qëndrueshëm krahasuar me vitin 2023 (44.5%). Edhe pse rritja është modeste (+0.2 pikë përqindje), ajo tregon ruajtje të kapaciteteve ekzistuese të infrastrukturës bujqësore dhe menaxhim të mirë të rrjetit pa humbje në mbulim.

Në total, 7 419 hektarë tokë bujqësore mbeten të mbuluara nga rrjeti i kanaleve ujitëse dhe kulluese në të gjithë territorin e bashkisë, duke kontribuar në rritjen e produktivitetit dhe sigurisë ushqimore.

2. Përmirësimi i funksionalitetit të kanaleve

- Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale është rritur nga 58.1% në 64.4%, me një përmirësim prej 11%. Ky rezultat është tregues i rritjes së investimeve dhe mirëmbajtjes teknike në rrjetin hidroteknik.
- Kanale ujitëse funksionale: nga 43.6% në 48.3%, një rritje prej +4.7 km në gjatësi funksionale (nga 100.4 km në 111.7 km).

- Kanale kulluese funksionale: nga 72.7% në 80.5%, një rritje prej +7.8 km në gjatësi funksionale (nga 56.7 km në 62.8 km).

Këto përmirësime reflektojnë investime në pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve, si dhe rëndësinë e mirëmbajtjes preventive për mbrojtjen e tokës bujqësore nga përmbytjet dhe degradimi.

3. Ndikimi në produktivitet dhe qëndrueshmëri

Rritja e funksionalitetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të kultivimit bujqësor, sidomos në zonat me kultura intensive dhe në fushat e Shushicës, Bradasheshit dhe Shirgjanit.

Përmirësimi i rrjetit ka reduktuar problematikat sezonale të mbingopjes me ujë dhe mungesës së kullimit, duke ndihmuar në rritjen e sipërfaqeve të punuara dhe mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozioni.

A) TREGUESIT PËRMBLEDHËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	44.53	44.73	0.20	↑	Përmirësuar	l	0%
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	58.13	64.40	6.28	↑	Përmirësuar	l	11%
Tregues	Mbulimi i kostos së shërbimit nga të ardhurat	%	77.64	128.51	50.88	↑	Përmirësuar	l	66%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	43.58	48.31	4.74	↑	Përmirësuar	l	11%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	72.67	80.49	7.82	↑	Përmirësuar	l	11%

B) SHTOJCË: TË DHËNAT BURIM (TBL_TEDHENAT)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	16662.00	16587.00	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	7419.00	7419.00	Hektarë
Gjatësia e kanaleve ujitëse	230.40	231.20	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	100.40	111.70	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese	78.02	78.02	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	56.70	62.80	Kilometër (km)
Shpenzimet per menaxhimin e shërbimit të kanaleve të ujitjes dhe kullimit	7365.00	6120.00	Mije Leke
Te ardhurat nga menaxhimi i shërbimit të kanaleve të ujitjes dhe kullimit	5718.00	7865.00	Mije Leke



Përshkrim i përgjithshëm : Funkcioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullësor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

ANALIZA E SHËRBIMIT


Në vitin 2024, bashkia Elbasan ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm të administrimit të fondit pyjor dhe kullësor, me një sipërfaqe totale prej 54,979 ha, nga të cilat 55% janë të mbuluara me plane të miratuara mbarështimi. Ky rezultat dëshmon për vazhdimësi në menaxhimin afatgjatë të resurseve natyrore dhe zbatimin e planit vendor të mbarështimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Megjithatë Në raport me vitin 2023, **numri i punonjësve të shërbimit të pyjeve dhe kullotave është rritur nga 19 në 20**, duke përmirësuar lehtë raportin e mbikëqyrjes nga **0.3456 në 0.3638 punonjës për 1,000 ha**.

Një tjetër tregues me rëndësi, “Mbulimi i kostos së shërbimit nga të ardhurat”, ka pësuar rënie të dukshme nga 99.3% në vetëm 41.9%.

Në këtë kontekst, performanca mbetet e qëndrueshme në aspektin teknik, por duhet ndjekur me kujdes në aspektin financiar.

Aspekte të shërbimit	Sfida kryesore (2024)	Arritjet 2024	Objektivat 2025
 Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	Rritje e vogël e numrit të punonjësve nga 19 në 20, duke përmirësuar raportin e mbikëqyrjes nga 0.3456 → 0.3638 punonjës/1,000 ha, por ende nën nivelin e duhur për një territor prej 55 mijë ha.	• Ruajtje e 55% të sipërfaqes së mbuluar me plane mbarështimi. • Zbatim i planit vendor për të dytin vit radhazi. • Rritje e kapaciteteve të stafit (trajnim nga 2 në 3 punonjës)	• Rritje graduale e numrit të punonjësve pyjorë, në përputhje me standardin kombëtar. • Përditësim i inventarit të fondit pyjor dhe forcim i mbikëqyrjes në terren. • Zgjerim i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve teknike të stafit.
☐ Mbarështimi i qëndrueshëm i resurseve	Mungesë fondesh të mjaftueshme për rigjenerim pyjor, rehabilitim të kullotave të dëmtuara dhe masa preventive ndaj degradimit.	• Zbatim i planeve ekzistuese të mbarështimit. • Ruajtje e mbulesës pyjore në zonat me prioritet ekologjik.	• Aplikim në skema financimi të BE-së dhe të Ministrisë së Bujqësisë për rigjenerim pyjor dhe rehabilitim të kullotave. • Hartimi i një skeme të re tarifimi që pasqyron koston reale të shërbimit. • Rritje e efikasitetit financiar me synim arritjen e mbulimit të koston > 70%. • Përmirësim i logjistikës dhe pajisjeve për patrullim e ndjekje territoriale.



A)TREGUESIT PERMBLEDHESE

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	55.00	55.00	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/ 1000 ha	0.35	0.36	0.02	↑	Përmirësuar		5%
Tregues	Mbulimi I kostos së shërbimit nga të ardhurat	%	99.33	41.96	-57.37	↓	Përkeqësuar		-58%
Tregues	Numri i marreveshjeve nderbashkiake per menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	Numër	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim		
Tregues	Shkalla e trainimit te punonjesve te sherbimit	Numër	10.53	15.00	4.47	↑	Përmirësuar		43%

TE DHËNAT

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo)
Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	54979.01	54979.01	Hektarë
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	30237.00	30237.00	Hektarë
Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	19.00	20.00	Numër
Shpenzimet per menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	47723892.00	71680000.00	Mije Leke
Te ardhurat nga menaxhimi I sherbimit te fondit pyjor dhe kullosur	47405335.00	30078623.00	Mije Leke
Numri i marreveshjeve nderbashkiake per menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	0.00	0.00	Numër
Numri I punonjesve te sherbimit te menaxhimit te fondit pyjor dhe kullosor te trajnuar gjate vitit	2.00	3.00	Numër



MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

ANALIZA E SHËRBIMIT

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ka ruajtur një funksionim të qëndrueshëm të sistemit të mbrojtjes sociale, me **zbatim të plotë të Planit Vendor Social** dhe funksionim të pandërprerë të mekanizmave të referimit për rastet në nevojë.

Të gjitha rastet e referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) kanë përfituar shërbime sociale (100%), duke dëshmuar koordinim të mirë ndër-institucional. Po ashtu, bashkia ka siguruar **trajtim 100% të fëmijëve me nevojë mbrojtjeje** si në vitin 2023, ashtu edhe në vitin 2024.

Në mbështetjen për **personat me aftësi të kufizuara (PAK)**, shkalla e përfitimit ka shënuar rritje të lehtë nga 82.5% në 83.9%, me përmirësim domethënës për grupmoshën **18+ vjeç (+9%)**. Ndërkohë, mbulimi për **fëmijët me aftësi të kufizuara** ka pësuar ulje (-11%), duke sinjalizuar nevojën për forcim të ndërhyrjeve të hershme, diagnostikim më të shpejtë dhe shërbime gjithëpërfshirëse.

Në fushën e **ndihmës ekonomike**, numri i familjeve përfituese është ulur nga 4,683 në 3,923 (-16%), ndërsa **niveli i mbulimit mbetet i lartë (95%)**.


Mbështetja për familjet rome ka mbetur e qëndrueshme (95%), ndërsa për familjet e tjera ka rënë në 87%.

Sa i përket **strehimit social**, shkalla e miratimit të kërkesave ka rënë nga 98.9% në 88.7%, kryesisht për shkak të fondeve të kufizuara dhe prioritizimit të rasteve me urgjencë më të lartë. Numri i qendrave sociale (4 ditore dhe 5 rezidenciale) ka mbetur i pandryshuar, duke garantuar **stabilitet**, por jo zgjerim të kapaciteteve përballë rritjes së numrit të përfituesve.

Në përgjithësi, performanca e Bashkisë Elbasan në mbrojtjen sociale mbetet **e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe e orientuar drejt nevojave reale të qytetarëve**, me rezultate të forta në koordinim dhe në zbatimin e politikave vendore.

Megjithatë, mbeten sfida të qarta në **zgjerimin e shërbimeve komunitare, përmirësimin e mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara**, si dhe në **forcimin ekonomik të familjeve përfituese**.

Kategoria	Përshkrimi
Arritjet 2024	- Zbatim i plotë i Planit Vendor Social dhe funksionim i MKR me mbulim 100% të rasteve. - Përmirësim i lehtë i mbështetjes për PAK (83.9%) dhe ruajtje e përfshirjes gjinore të barabartë në shërbime. - Rritje e numrit të rasteve të trajtuara për dhunë në familje dhe përfshirje e plotë në shërbime sociale. - Mbulim i plotë i rasteve të fëmijëve me nevojë mbrojtje
Sfida	- Ulje e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe strehimit social për shkak të mungesës së fondeve dhe kritereve më të ngushta. - Ulje e mbulimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara (- 11%). - Kapacitete të kufizuara për zgjerimin e qendrave sociale komunitare dhe rezidenciale.
Objektivat 2025	- Rritje e shkallës së mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara në $\geq 90\%$. - Hartim i programeve të reja të fuqizimit ekonomik për përfituesit e ndihmës sociale. - Zgjerim i rrjetit të qendrave ditore komunitare dhe përmirësim i kapaciteteve për strehim social. - Përdorim i të dhënave të MKR dhe PAK për hartimin e politikave të personalizuara lokale.



A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	95.96	95.29	-0.68	↓	Përkeqësuar	●	-1%
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	98.97	88.71	-10.26	↓	Përkeqësuar	●	-10%
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare publike, të licensuara për 10,000 banorë	qendra/10,000 banorë	0.78	0.76	-0.01	↓	Përkeqësuar	●	-2%
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	82.50	83.90	1.39	↑	Përmirësuar	●	2%
Tregues	Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Shkalla e trajtimit me shërbim e fëmijëve në nevojë mbrojtje	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve femra të referuara nga mekanizmi i	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

	koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale								
Nen-tregues	Përqindja e rasteve meshkuj të referuar nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 0-17 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 18-29 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 30-44 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 45-59 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 60+ vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e femrave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	87.18	84.06	-3.12	↓	Përkeqësuar	●	-4%
Nen-tregues	Përqindja e meshkujve me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	78.68	83.76	5.08	↑	Përmirësuar	●	6%
Nen-tregues	Përqindja e personave grupmosha 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	118.37	104.82	-13.56	↓	Përkeqësuar	●	-11%
Nen-tregues	Përqindja e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	69.35	75.82	6.47	↑	Përmirësuar	●	9%
Nen-tregues	Përqindja e familjeve rome që marrin ndihmë ekonomike	%	95.90	95.00	-0.90	↓	Përkeqësuar	●	-1%
Nen-tregues	Përqindja e familjeve me etni të tjera (jo rome) që marrin ndihmë ekonomike	%	95.50	87.05	-8.44	↓	Përkeqësuar	●	-9%

B) SHTOJCË: TË DHËNAT BURIM (TBL_TEDHENAT)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	4880.00	4117.00	Numër
Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	4683.00	3923.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	115746.00	117726.00	Numër
Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	485.00	310.00	Numër
Numri i personave përfitues të strehimit social	480.00	275.00	Numër
Numri i qendrave sociale ditore funksionale	4.00	4.00	Numër
Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	5.00	5.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	165.00	208.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	165.00	208.00	Numër
Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	1126.00	1267.00	Numër
Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	929.00	1063.00	Numër
Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilesore(Po=1/Jo=0)
Numri i fëmijëve me nevojë mbrojtjeje menaxhuara nga Bashkia brenda territorit të saj	87.00	108.00	Numër
Numri i fëmijëve me nevojë mbrojtjeje brenda territorit të bashkisë, të cilëve I është ofruar ky shërbim	87.00	108.00	Numër



Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

ANALIZA E SHERBIMIT

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ka ruajtur një funksionim të qëndrueshëm të sistemit të mbrojtjes sociale, me **zbatim të plotë të Planit Vendor Social** dhe funksionim të pandërprerë të mekanizmave të referimit për rastet në nevojë.

Të gjitha rastet e referuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) kanë përfituar shërbime sociale (100%), duke dëshmuar koordinim të mirë ndërinstitutional. Po ashtu, bashkia ka siguruar **trajtim 100% të fëmijëve me nevojë mbrojtjeje** si në vitin 2023, ashtu edhe në vitin 2024.

Në mbështetjen për **personat me aftësi të kufizuara (PAK)**, shkalla e përfitimit ka shënuar rritje të lehtë nga 82.5% në 83.9%, me përmirësim domethënës për grupmoshën **18+ vjeç (+9%)**. Ndërkohë, mbulimi për **fëmijët me aftësi të kufizuara** ka pësuar ulje (-11%), duke sinjalizuar nevojën për forcim të ndërhyrjeve të hershme, diagnostikim më të shpejtë dhe shërbime gjithëpërfshirëse.

Në fushën e **ndihmës ekonomike**, numri i familjeve përfituese është ulur nga 4,683 në 3,923 (-16%), ndërsa **niveli i mbulimit mbetet i lartë (95%)**.


Mbështetja për familjet rome ka mbetur e qëndrueshme (95%), ndërsa për familjet e tjera ka rënë në 87%.

Sa i përket **strehimit social**, shkalla e miratimit të kërkesave ka rënë nga 98.9% në 88.7%, kryesisht për shkak të fondeve të kufizuara dhe priorizimit të rasteve me urgjencë më të lartë. Numri i qendrave sociale (4 ditore dhe 5 rezidenciale) ka mbetur i pandryshuar, duke garantuar **stabilitet**, por jo zgjerim të kapaciteteve përballë rritjes së numrit të përfituesve.

Në përgjithësi, performanca e Bashkisë Elbasan në mbrojtjen sociale mbetet **e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe e orientuar drejt nevojave reale të qytetarëve**, me rezultate të forta në koordinim dhe në zbatimin e politikave vendore.

Megjithatë, mbeten sfida të qarta në **zgjerimin e shërbimeve komunitare, përmirësimin e mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara**, si dhe në **forcimin ekonomik të familjeve përfituese**.

Kategoria	Përshkrimi
Arritjet 2024	- Zbatim i plotë i Planit Vendor Social dhe funksionim i MKR me mbulim 100% të rasteve. - Përmirësim i lehtë i mbështetjes për PAK (83.9%) dhe ruajtje e përfshirjes gjinore të barabartë në shërbime. - Rritje e numrit të rasteve të trajtuara për dhunë në familje dhe përfshirje e plotë në shërbime sociale. - Mbulim i plotë i rasteve të fëmijëve me nevojë mbrojtje
Sfida	- Ulje e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe strehimit social për shkak të mungesës së fondeve dhe kritereve më të ngushta. - Ulje e mbulimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara (- 11%). - Kapacitete të kufizuara për zgjerimin e qendrave sociale komunitare dhe rezidenciale.
Objektivat 2025	- Rritje e shkallës së mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara në $\geq 90\%$. - Hartim i programeve të reja të fuqizimit ekonomik për përfituesit e ndihmës sociale. - Zgjerim i rrjetit të qendrave ditore komunitare dhe përmirësim i kapaciteteve për strehim social. - Përdorim i të dhënave të MKR dhe PAK për hartimin e politikave të personalizuar lokale.



A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	95.96	95.29	-0.68	↓	Përkeqësuar	●	-1%
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	98.97	88.71	-10.26	↓	Përkeqësuar	●	-10%
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare publike, të licensuara për 10,000 banorë	qendra/10,000 banorë	0.78	0.76	-0.01	↓	Përkeqësuar	●	-2%
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	82.50	83.90	1.39	↑	Përmirësuar	●	2%
Tregues	Plan vendor social	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Shkalla e trajtimit me shërbim e fëmijëve në nevojë mbrojtje	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve femra të referuara nga mekanizmi i	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

	koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale								
Nen-tregues	Përqindja e rasteve meshkuj të referuar nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 0-17 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 18-29 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 30-44 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 45-59 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 60+ vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e femrave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	87.18	84.06	-3.12	↓	Përkeqësuar	●	-4%
Nen-tregues	Përqindja e meshkujve me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	78.68	83.76	5.08	↑	Përmirësuar	●	6%
Nen-tregues	Përqindja e personave grupmosha 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	118.37	104.82	-13.56	↓	Përkeqësuar	●	-11%
Nen-tregues	Përqindja e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	69.35	75.82	6.47	↑	Përmirësuar	●	9%
Nen-tregues	Përqindja e familjeve rome që marrin ndihmë ekonomike	%	95.90	95.00	-0.90	↓	Përkeqësuar	●	-1%
Nen-tregues	Përqindja e familjeve me etni të tjera (jo rome) që marrin ndihmë ekonomike	%	95.50	87.05	-8.44	↓	Përkeqësuar	●	-9%

B) SHTOJCË: TË DHËNAT BURIM (TBL_TEDHENAT)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	4880.00	4117.00	Numër
Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	4683.00	3923.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	115746.00	117726.00	Numër
Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	485.00	310.00	Numër
Numri i personave përfitues të strehimit social	480.00	275.00	Numër
Numri i qendrave sociale ditore funksionale	4.00	4.00	Numër
Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	5.00	5.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	165.00	208.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	165.00	208.00	Numër
Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	1126.00	1267.00	Numër
Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	929.00	1063.00	Numër
Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilesore(Po=1/Jo=0)
Numri i fëmijeve me nevojë mbrojtjeje menaxhuara nga Bashkia brenda territorit të saj	87.00	108.00	Numër
Numri i fëmijeve me nevojë mbrojtjeje brenda territorit të bashkisë, të cilëve I është ofruar ky shërbim	87.00	108.00	Numër

QEVERISJE E MIRË

Qeverisja e mirë përfaqëson kapacitetin institucional të bashkisë për të ushtruar funksionet publike me **integritet, transparencë, efikasitet dhe përgjegjshmëri**, duke siguruar përfshirjen qytetare dhe barazinë e mundësive për të gjithë grupet e komunitetit.

Në kuadër të Sistemit të Matjes së Performancës, qeverisja e mirë vlerësohet përmes katër fushave kryesore, të cilat pasqyrojnë cilësinë e proceseve të brendshme, kapacitetin administrativ dhe angazhimin e bashkisë për të ofruar shërbime të standardizuara dhe të besueshme.

 **Burimet Njerëzore** - Kjo fushë mat strukturën, profesionalizmin dhe stabilitetin e administratës vendore, duke vlerësuar kapacitetet e stafit, nivelin e trajnimeve, normat e zëvendësueshmërisë dhe përputhjen e strukturës organizative me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike. Performanca në këtë komponent është thelbësore për cilësinë e përgjithshme të qeverisjes vendore.

2.  Transparenca - Transparenca vlerëson hapjen e bashkisë ndaj qytetarëve përmes publikimit të akteve, buxheteve, programeve, vendimeve, raportimeve zyrtare dhe informacionit të interesit publik.

Ky tregues mat gjithashtu funksionimin e kanaleve të komunikimit, respektimin e standardeve të qeverisjes së hapur dhe qasjen në të dhëna të verifikueshme.

 **Barazia Gjinore** - Ky komponent reflekton angazhimin institucional për të siguruar **përfaqësim të barabartë**, politikëbërje të ndjeshme ndaj gjinisë dhe integrim të perspektivës gjinore në programet dhe buxhetet vendore.

Vlerësohen indikatorë që lidhen me balancën e stafit, përfshirjen gjinore në vendimmarrje dhe qasjen e barabartë në shërbimet publike.

4. EU Integrimi në Bashkimin Evropian - Kjo fushë mat aftësinë e bashkisë për të përafruar praktikatat e saj me standardet dhe parimet e BE-së, përmes:

- strukturave të dedikuara për integrimin,
- bashkëpunimeve ndërbashkiake,
- projekteve me financim evropian,
- procesit të rregullt të vetëvlerësimit sipas kapitujve të acquis.

Ky komponent nxit modernizimin, dixhitalizimin dhe përputhshmërinë e qeverisjes vendore me drejtimet strategjike të BE-së.



BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit – duke përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

ANALIZA E SHERBIMIT

Gjatë vitit 2024, Bashkia Elbasan ka shënuar ulje të ndjeshme të numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe ristrukturim të njësive organizative, çka ka ndikuar në disa tregues kyç të performancës.

Megjithatë, është vërejtur përmirësim domethënës në stabilitetin e stafit, pasi rotacioni i punonjësve ka rënë në mënyrë të ndjeshme, duke treguar qëndrueshmëri dhe konsolidim të administratës vendore pas periudhave me qarkullim të lartë.

1. Struktura dhe numri i punonjësve

- ☐ Numri i përgjithshëm i punonjësve ka rënë nga **1,464** → **1,388** (–5%), si rezultat i optimizimit të strukturave dhe uljes së kontratave të shërbimeve të nënkontraktuara.
- ☐ Numri i punonjësve të shërbimeve të jashtme ka rënë ndjeshëm nga **1,014** → **435** (–57%), duke reflektuar racionalizim të shpenzimeve dhe rishpërndarje të përgjegjësisë drejt stafit të brendshëm.
- ☐ Në raport me popullsinë **117,726 banorë**, bashkia ka **11.79 punonjës për 1,000 banorë**, një nivel më i ulët se viti i kaluar, por që tregon efikasitet më të lartë në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe në organizimin e stafit sipas nevojave reale të funksioneve bashkiake

2. Rotacioni i stafit dhe stabiliteti institucional


- ☐ Shkalla e rotacionit të punonjësve ka rënë ndjeshëm nga **12.64%** → **2.02%** (–84%), duke dëshmuar një stabilitet të lartë në administratë.
- ☐ Për femrat, rotacioni ka rënë nga **7.46%** → **0.72%** (–90%), ndërsa për meshkujt nga **20.24%** → **3.99%** (–80%).


□ Në njësitë shpenzuese vërehet një rritje e lehtë e rotacionit (+17%), e lidhur me karakterin sezonal dhe operativ të disa shërbimeve.

Ky rezultat përbën një tregues të rëndësishëm të konsolidimit institucional dhe reduktimit të lëvizjeve të shpeshta të stafit, duke rritur përvojën e brendshme dhe ulur kostot administrative.

3. Trajnimi dhe zhvillimi profesional

- Numri i punonjësve të trajnuar ka rënë nga **350** → **243** (−27%), duke ulur përqindjen e stafit të trajnuar nga **23.9%** → **17.5%**.
 - Përqindja e stafit femër të trajnuar ka mbetur pothuajse e qëndrueshme (−2%), ndërsa përqindja e stafit mashkull të trajnuar ka rënë ndjeshëm (−55%).
 - Një rezultat pozitiv vërehet te njësitë shpenzuese, ku përqindja e stafit të trajnuar është rritur nga **1.97%** → **8.97%** (+355%), duke reflektuar një fokus të ri në trajnimin e sektorëve teknikë dhe atyre që operojnë drejtpërdrejt në terren.
- Ky orientim tregon një qasje më strategjike të bashkisë, duke i dhënë prioritet ngritjes së kapaciteteve të atyre strukturave që ndikojnë më shumë në cilësinë e shërbimeve publike.





A) TREGUESIT PËRMBLEDHËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	12.64	2.02	-10.62	↓	Përkeqësuar	●	-84%
Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	23.91	17.51	-6.40	↓	Përkeqësuar	●	-27%
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	punonjës/1,000 banorë	21.41	15.49	-5.92	↓	Përkeqësuar	●	-28%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve femra të bashkisë	%	7.46	0.72	-6.74	↓	Përkeqësuar	●	-90%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve meshkuj të bashkisë	%	20.24	3.99	-16.25	↓	Përkeqësuar	●	-80%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të administratës të bashkisë	%	12.64	2.02	-10.62	↓	Përkeqësuar	●	-84%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të njësive shpenzuese të bashkisë	%	3.94	4.60	0.65	↑	Përmirësuar	●	17%
Nen-tregues	Përqindja e stafit femra të trajnuar	%	22.96	22.49	-0.47	↓	Përkeqësuar	●	-2%

Nen-tregues	Përqindja e stafit meshkuj të trajnuar	%	21.92	9.96	-11.96	↓	Përkeqësuar	●	-55%
Nen-tregues	Përqindja e stafit të administratës të trajnuar	%	22.54	14.70	-7.84	↓	Përkeqësuar	●	-35%
Nen-tregues	Përqindja e stafit të njësive shpenzuese të trajnuar	%	1.97	8.97	6.99	↑	Përmirësuar	●	355%

C) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	1464.00	1388.00	Numër
Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	185.00	28.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	115746.00	117726.00	Numër
Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	350.00	243.00	Numër
Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	1014.00	435.00	Numër

Sfida	Arritje	Objektiva 2025
Ulje e numrit të punonjësve (1,464 → 1,388) dhe reduktim i stafit të nënkontraktuar	Rënie e rotacionit nga 12.64% në 2.02% , duke sjellë stabilitet të lartë administrativ	Rritje e pjesëmarrjes në trajnime dhe ruajtje e stabilitetit të stafit
Rënie e numrit të trajnuarve (350 → 243) dhe përfshirje e ulët e stafit administrativ në trajnime	Rritje e trajnimeve në njësitë shpenzuese (1.97% → 8.97%) , duke forcuar kapacitetet teknike	Krijim i planit vjetor të trajnimeve , me përfshirje të barabartë gjinore dhe fokus te stafi administrativ
Raport i ulët staf/banor (11.79 punonjës për 1,000 banorë, nën nivelin e nevojshëm për ofrimin e 40 funksioneve bashkiake)	Balancë gjinore e qëndrueshme (≈52% gra) dhe efikasitet më i lartë në menaxhimin e burimeve	Përmirësim i raportit staf/banor dhe rritje e kapaciteteve teknike dhe operacionale

TRANSPARENCA

Të dhëna të Përgjithshme: Transparenca në pushtetin vendor është parimi që siguron që qytetarët të kenë qasje të lirë dhe të kuptueshme në informacionin publik, dokumentet zyrtare, si dhe proceset vendimmarrëse të njësisë vendore. Ajo nënkupton publikimin e vendimeve, buxhetit, planeve dhe raporteve të ndryshme, duke mundësuar që qytetarët të jenë të informuar, të përfshihen në konsultime publike dhe të kërkojnë llogari nga institucionet lokale për veprimet apo mosveprimet e tyre. Transparenca forcon besimin mes qytetarëve dhe qeverisjes vendore, dhe ndihmon në parandalimin e abuzimeve apo korrupsionit.

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm të transparencës institucionale, duke e konsoliduar praktikën e raportimit dhe publikimit të informacionit zyrtar.

1. Raportimi dhe transparenca formale

Në vitin 2024, për herë të parë u hartua dhe publikua Raporti Vjetor për Transparencën në Procesin e Vendimmarrjes, duke përmbushur një detyrim ligjor të rëndësishëm sipas Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Ky tregues, i cilësuar si më i miri për vitin 2024, tregon një angazhim real të administratës për transparencë proaktive dhe forcim të përgjegjshmërisë publike në raport me qytetarët.

2. Konsultimet publike dhe pjesëmarrja qytetare

Numri i akteve për të cilat është zhvilluar konsultim publik është rritur nga 5 në 9, duke ruajtur përqindjen 100% të mbulimit të detyrimit ligjor për konsultim publik.

Ky rezultat tregon se Bashkia Elbasan ka arritur të respektojë plotësisht kërkesat ligjore për konsultim, duke ruajtur një nivel të lartë formal të transparencës pjesëmarrëse.

Megjithatë, nevojitet intensifikim i pjesëmarrjes reale qytetare në këto konsultime përmes kanaleve dixhitale, bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe OGP Forumit vendor.

3. Integriteti institucional

Gjatë viteve 2023 dhe 2024, Bashkia Elbasan nuk ka pasur një Plan Vendor të Integritetit të miratuar dhe në zbatim, çka tregon se ndërtimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit, forcimit të etikës publike dhe menaxhimit të riskut të integritetit ka qenë ende në fazë përgatitore.

Mungesa e këtij dokumenti strategjik për dy vite radhazi është një boshllëk institucional që ka kufizuar aftësinë e bashkisë për të konsoliduar transparencën etike, për të formalizuar përgjegjshmërinë administrative, si dhe një sistem të qëndrueshëm të monitorimit të integritetit.

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2024	Objektivat 2025
 Transparenca dhe Integriteti Institucional	Mungesë e Planit Vendor të Integritetit për periudhën 2023–2024, që ka kufizuar formalizimin e mekanizmave të etikës dhe parandalimit të korrupsionit	Për herë të parë është hartuar dhe publikuar Raporti Vjetor për Transparencën në Procesin e Vendimmarrjes, duke përmbushur plotësisht detyrimin ligjor sipas Ligjit nr. 146/2014	Zbatim Planit Vendor të Integritetit 2025–2028, forcim i sistemit të monitorimit të integritetit dhe ndërtim i një kulture të qëndrueshme etike në administratë
 Konsultimet Publike dhe Pjesëmarrja Qytetare	Pjesëmarrje e kufizuar e qytetarëve në konsultime publike dhe mungesë e përdorimit aktiv të kanaleve digjitale	Rritje e numrit të akteve të konsultuara (nga 5 → 9) dhe ruajtje e mbulimit 100% të detyrimit ligjor për konsultime	Krijimi i platformave online për konsultim publik dhe rritje e bashkëpunimit me OJF-të dhe OGP Forumet vendore
 Raportimi dhe Publikimi i të Dhënave	Mungesë e harmonizimit mes raportimeve vjetore dhe publikimeve në portalet zyrtare	Konsolidim i praktikës së raportimit dhe publikimit të informacionit zyrtar në mënyrë të plotë dhe të aksesueshme	Zhvillim i sistemit të raportimit digjital dhe integrimi me portalet kombëtare të transparencës

A) TREGUESIT PËRMBLEDHËS)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	Përmirësuar	●	
Tregues	Plani Vendor i Integritetit	Cilësore (Po/Jo)	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	

B) SHTOJCË: TË DHËNAT BURIM (TBL_TEDHENAT)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	5.00	9.00	Numër
Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	5.00	9.00	Numër
Publikimi i raportit vjetor për transparencën	0.00	0.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0.00	0.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)

BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; • buxhetim të përgjigjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi; • ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre; • mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination) dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione kyçe, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ruan një nivel të qëndrueshëm të përfaqësimit gjinor në drejtim politik dhe administrativ, megjithëse me ndryshime të lehta në strukturën e brendshme.

Përfaqësimi i grave në pozicione politike dhe drejtuese të zgjedhura (kryetare/zv.kryetare, administratore, këshilltare bashkiake) ka pësuar një ulje të lehtë nga 39.2% në 36.5%. Në terma absolutë, nga 74 pozicione politike dhe menaxheriale të zgjedhura, 27 mbahen nga gra në vitin 2024, kundrejt 29 në vitin paraardhës. Kjo sinjalizon nevojën për forcimin e mekanizmave të përfaqësimit të grave në vendimmarrje lokale.

Në të kundërt, përfaqësimi i grave në nivelet drejtuese administrative (pozicionet e larta, të mesme dhe të ulëta) ka shënuar rritje nga 39.1% në 41.4%. Ky përmirësim tregon një balancë më të mirë gjinore në administratën e brendshme dhe një prirje pozitive drejt fuqizimit të grave në role menaxheriale dhe ekzekutive.

Pozitiv mbetet fakti që Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore vijon të jetë në fuqi dhe në zbatim, duke garantuar kornizën institucionale për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe praktikën e bashkisë.

Në përgjithësi, Bashkia Elbasan ruan stabilitet në barazinë gjinore, por kërkon ndërhyrje të synuara për rritjen e përfaqësimit të grave në pozicione të zgjedhura dhe rritjen e diversitetit gjinor në strukturat vendimmarrëse.

A) TREGUESIT PËRMBLEDHËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	39.19	36.49	-2.70	↓	Përkeqësuar	●	-7%
Tregues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	39.06	41.38	2.32	↑	Përmirësuar	●	6%
Tregues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

B) SHTOJCË: TË DHËNAT BURIM (TBL_TEDHENAT)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	74.00	74.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	29.00	27.00	Numër
Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	64.00	58.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	25.00	24.00	Numër
Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po/Jo).

EU INTEGRIMI EVROPIAN

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me *acquis communautaire* dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;
- Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik.

Në vitin 2024, Bashkia Elbasan ka ruajtur stabilitet të plotë institucional në mekanizmat që lidhen me procesin e integrimit evropian, duke përforcuar bashkëpunimin ndërbashkiak dhe duke mbajtur nivel të lartë suksesi në projektet e financuara nga BE.

Strukturat e integrimit evropian dhe të performancës vijojnë të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme, si pjesë e organizimit funksional të bashkisë

Një zhvillim pozitiv gjatë vitit është nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërbashkiake, duke përmirësuar ndjeshëm bashkëpunimin horizontal me bashki të tjera për zbatimin e politikave dhe projekteve të përbashkëta.

Në fushën e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, Bashkia Elbasan ka ruajtur një nivel shumë të mirë të efikasitetit: nga 14 projekte të aplikuara, 11 janë fituar, duke arritur një shkallë suksesi prej 78.6%. Edhe pse ka një rënie shumë të lehtë krahasuar me vitin 2023 (kur shkalla e suksesit ishte 80%), performanca mbetet ndër më të lartat në nivel vendor, duke reflektuar përvojën dhe kapacitetet e konsoliduara të bashkisë në përgatitjen e aplikimeve cilësore dhe menaxhimin e fondeve europiane.

Në nivel strategjik, Plani Vendor për Migracionin dhe Diasporën mbetet në fuqi dhe i zbatuar, duke shërbyer si dokument orientues për lidhjen me komunitetet jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin lokal. Po ashtu, Komisioni i Integrimit Evropian pranë Këshillit Bashkiak funksionon në mënyrë të rregullt, duke siguruar integrimin e perspektivës evropiane në proceset e vendimmarrjes vendore.

Në përmbledhje, Bashkia Elbasan paraqet një performancë të qëndrueshme dhe të konsoliduar në drejtim të integrimit evropian, me bashkëpunim të zgjeruar ndërbashkiak, shkallë të lartë suksesi

në projektet e BE-së dhe mbështetje të vazhdueshme institucionale për strukturat e integritit dhe diasporës. Sfida për të ardhmen mbetet rritja e numrit të marrëveshjeve dhe projekteve rajonale, si dhe thellimi i përfshirjes së qytetarëve në proceset e integritit përmes mekanizmave të pjesëmarrjes vendore.

A) TREGUESIT PËRMBLEDHËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	0.00	1.00	1.00	↑	Përmirësuar	●	
Tregues	Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	%	80.00	78.57	-1.43	↓	Përkeqësuar	●	-2%
Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Komisionet e integritit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

B) SHTOJCË: TË DHËNAT BURIM (TBL_TEDHENAT)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara	0.00	1.00	Numër
Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=Bosh).
Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integritimit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	0.00	0.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).
Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës se raportimit	10.00	14.00	Numër
Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës se raportimit	8.00	11.00	Numër
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).
Komisionet e Integritimit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	1.00	1.00	Cilësore (Po=0/Jo=Bosh).

MENAXHIMI FINANCIAR

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxhetimi. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Në vitin 2024, bashkia ka ruajtur një pozicion të qëndrueshëm fiskal, duke shënuar përmirësim në shumicën e treguesve të performancës financiare. **Të ardhurat e veta për frymë u rritën nga 11,309 lekë në 13,349 lekë (+18%), ndërsa pesha e tyre ndaj transfertave u rrit në 93.3%, duke reflektuar një nivel të lartë të vetëfinansimit lokal. Po ashtu, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit arriti në 48.3%, duke sinjalizuar rritje të peshës së të ardhurave vendore në strukturën e përgjithshme të buxhetit.**

Në të njëjtën kohë, **investimet për frymë u rritën ndjeshëm, nga 3,350 lekë në 4,701 lekë (+40%), ndërsa pjesa e investimeve në buxhet u rrit nga 16% në 19.6%,** një tregues pozitiv për orientimin drejt projekteve zhvillimore dhe përmirësimit të infrastrukturës publike. Kjo rritje është mbështetur edhe nga përmirësimi i **shkallës së ekzekutimit të buxhetit, e cila u rrit nga 65.7% në 71.8%,** duke reflektuar efikasitet më të lartë në menaxhimin e shpenzimeve.


Nga ana tjetër, **detyrimet e papaguara ndaj të tretëve janë ulur ndjeshëm, nga 5.1% në vetëm 0.6% të totalit të shpenzimeve** — një arritje që tregon disiplinë të fortë buxhetore dhe menaxhim të kujdesshëm të likuiditetit.

Në aspektin e strukturës së shpenzimeve, **pjesa e shpenzimeve të personelit është ulur nga 50.7% në 47.7%,** ndërsa shpenzimet operationale janë stabilizuar në **32.7%,** duke krijuar hapësirë më të madhe për investime dhe shërbime të reja.

Megjithatë, mbetet sfida rritja e të ardhurave vendore në raport me potencialin fiskal të territorit dhe diversifikimi i burimeve të të ardhurave — veçanërisht përmes tarifave të lidhura me shërbimet publike dhe menaxhimin e pasurive bashkiake.

Në përgjithësi, performanca financiare e bashkisë në vitin 2024 dëshmon **rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të menaxhimit fiskal,** me tendencë drejt balancimit të qëndrueshëm midis të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve zhvillimore.

Treguesit Financiare Leke/Frymë, 2023-2024



Kategoria	Përshkrimi
Arritjet 2024	- Rritje e të ardhurave të veta për frymë me +18% , duke arritur në 13,349 lekë/banor. - Rritje e peshës së të ardhurave vendore në buxhet në 48.3% . - Ulje drastike e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve (-89%), në vetëm 0.6%. - Rritje e investimeve për frymë me +40% dhe përmirësim i ekzekutimit të buxhetit nga 65.7% → 71.8% (+9%).
Sfida	- Varësi ende e lartë nga transfertat qendrore për disa programe të qëndrueshme. - Potencial i pashfrytëzuar për rritjen e bazës tatimore vendore (taksa pasurie, biznesi, tarifa shërbimesh). - Nevojë për modernizim të sistemit të mbledhjes së të ardhurave dhe dixhitalizim të plotë të proceseve fiskale .
Objektivat 2025	- Rritje e peshës së të ardhurave vendore mbi 50% të buxhetit. - Zhvillim i një plani fiskal afatmesëm për ekuilibër të qëndrueshëm financiar. - Rritje e transparencës fiskale përmes publikimit të rregullt të raporteve të performancës. - Zgjerim i burimeve të të ardhurave përmes tarifave publike dhe menaxhimit më efikas të pasurive bashkiake.

A) Treguesit përmbledhës

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	leke/person	11309.61	13349.12	2039.52	↑	Përmirësuar	●	18%
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	87.98	93.33	5.34	↑	Përmirësuar	●	6%
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	46.80	48.27	1.47	↑	Përmirësuar	●	3%
Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	115.80	115.41	-0.39	↓	Përkeqësuar	●	0%
Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	16.54	19.92	3.38	↑	Përmirësuar	●	20%
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	leke/person	31771.75	33373.44	1601.69	↑	Përmirësuar	●	5%
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	65.68	71.79	6.12	↑	Përmirësuar	●	9%
Tregues	Investime për frymë	leke/person	3350.03	4701.03	1350.99	↑	Përmirësuar	●	40%
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	16.05	19.62	3.57	↑	Përmirësuar	●	22%
Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	5.12	0.57	-4.55	↓	Përkeqësuar	●	-89%

Tregues	Pesha e personelit në buxhet	%	50.69	47.70	-2.98	↓	Përkeqësuar	●	-6%
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	33.26	32.68	-0.58	↓	Përkeqësuar	●	-2%

B) Shtojcë: Të dhënat burim (Tbl_TeDhenat)

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Të ardhurat e veta, fakt	1309042.00	1571539.00	Mijë Leke
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	115746.00	117726.00	Numër
Transfertat gjithsej, fakt	1487807.00	1683900.00	Mijë Leke
Të ardhurat e përgjithshme, fakt	2796849.00	3255439.00	Mijë Leke
Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt	2415292.00	2820760.00	Mijë Leke
Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	216471.00	312984.00	Mijë Leke
Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	3677453.00	3928922.00	Mijë Leke
Shpenzime kapitale, fakt	387753.00	553433.00	Mijë Leke
Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	123669.00	16015.00	Mijë Leke
Shpenzime personeli, fakt	1224236.00	1345591.00	Mijë Leke
Shpenzime operacionale, fakt	803303.00	921736.00	Mijë Leke

PERFUNDIME REKOMANDIME

Performanca e Bashkisë Elbasan gjatë **vitit 2024** tregon një progres të qëndrueshëm në shumicën e fushave të matjes së shërbimeve publike, veçanërisht në menaxhimin financiar, arsimin parauniversitar, mbrojtjen sociale dhe qeverisjen e mirë. Rezultatet pozitive në vetëfinancim, rritjen e investimeve publike, barazinë gjinore në qasje dhe forcimin e përfshirjes sociale dëshmojnë për një administratë aktive, të orientuar drejt rezultateve dhe të mbështetur në vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

Megjithatë, **mbeten sfida** të qarta në menaxhimin e burimeve njerëzore, rritjen e të ardhurave vendore në raport me potencialin fiskal të territorit, si dhe modernizimin e infrastrukturës së shërbimeve publike — veçanërisht në zonat rurale. Rënia e lehtë e disa treguesve në arsimin parauniversitar dhe strehimin social lidhet kryesisht me faktorë demografikë, kufizime buxhetore dhe kapacitete të pamjaftueshme në disa njësi të shërbimit.

Në vijim, rekomandohen këto prioritetë për vitin 2025:

- **Konsolidimi i Planifikimit Strategjik Vendor**, me lidhje të qartë ndërmjet planeve të sektorëve dhe objektivave buxhetore;
- **Forcimi i performancës në shërbimet sociale dhe edukative**, me fokus te grupet vulnerabël dhe fëmijët;
- **Zhvillimi i sistemit të matjes dhe raportimit dixhital të performancës**, për të rritur transparencën dhe efikasitetin e administratës;
- **Rritja e të ardhurave vendore dhe menaxhimi më i mirë i aseteve publike**, për të siguruar qëndrueshmëri financiare afatgjatë;
- **Integrimi i standardeve të BE-së në politikat lokale**, veçanërisht në mjedis, barazi gjinore dhe qeverisje të mirë.

Në përfundim, Bashkia Elbasan mbetet ndër bashkitë me performancën më të lartë në nivel kombëtar, duke treguar potencial të qartë për të udhëhequr proceset e zhvillimit të qëndrueshëm vendor dhe për të shërbyer si model i qeverisjes së mirë dhe inovacionit në shërbimet publike në Shqipëri.